



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit



## KONTRATË/FURNIZIMI

### Emri i Projektit: FURNIZIMI ME INVENTAR PËR NEVOJAT E SHKOLLAVE TË KOMUNËS SË DRENASIT

Numri identifikues: 611-18-019-136, Datë: 14/05/2018; Nr. i arkivit; 400 - 27041  
**PALËT NË MARRËVESHJE**

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga MEHMET RAMA, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

N.T.P. " BURIMI DEKOR ", 600238580 , përfaqësuar nga BURIM PËRQUKU, Drejtor (më tutje kontraktuese).

#### NENI 1 LIGJI I APLIKUESHËM

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjt Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjt Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### NENI 2 LËNDA

Lënda e kontratës duhet të jetë : FURNIZIMI ME INVENTAR PËR NEVOJAT E SHKOLLAVE TË KOMUNËS SË DRENASIT

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të punëve/shërbimeve / furnizimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup>. Periudha e kryrjes se punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë në afatin prej : 18 ditëve.

#### NENI 3 ÇMIMI

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: 3,647.20 €, me fjalë (Tremijë e Gjashtëqind e Katërdhjetë e Shtatë euro e 20 cent).

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

#### NENI 4 PAGESAT

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet kur të raporton Komisioni për pranim, duke mos e tejkaluar shumën prej: 3,647.20 €.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë

se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkuesat thelbësore.

**4.3** Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së punëve/shërbimeve/furnizimeve duhet të jetë brenda 10 diteve. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik *Ligjt Nr. 04/L-042* për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria për Arsim.

- a) Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
- b) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë në Thesar nga Menaxheri apo Zyrtari ndërlidhës. Përqindja % e pagesës, të punëve/shërbimeve dhe furnizimeve të kryera do të caktohet nga Drejtoria për Arsim. Poashtu zyrtari ndërlidhës dokumentacionin duhet ta përcjellë për pagesë. Çdo faturë duhet të pranohet nëpërmes arkivit nga Drejtoria për Arsim.
- c) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për punë/shërbimeve/furnizime të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari ndërlidhes i Njesise kërkuese.
- d) Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj dhe një kopje ti sjellë në ZP. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkua nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

**Neni 5**

**Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

**5.1** Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

**5.2** Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6**

**Kualiteti**

**6.1** Kualiteti i furnizimeve/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7**

**Garancioni i shërbimeve**

**7.1** Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve (Deklaratë me shkrim - original).

**Neni 8**

**Vonesat në ekzekutim**

**8.1** Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njostim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9**

**Inspektimi dhe testimi**

**9.1** Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10**

**Nën-kontraktimi**

**10.1** Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë

Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

**11.1** Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtirim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

**12.1** Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

**13.1** Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.


**13.2** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në në pajtim me ligjin e Kosovës, Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 14 Komunikimi

**14.1** Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqipe në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe paralogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me 15/05/2018

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	MEHMET RAMA	Emri:	BURIM PËRQUKU
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtør
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14/05/2018	Data:	14/05/2018
Vula:		Vula:	